



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

NR 45 DATË 09.07.2021

**MBI SHPREHJEN E DAKORDËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES
NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR PUBLIK PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETIT
AGROTURIZËM NGA SHOQËRIA SALILLARI SHPK**

Këshilli i Bashkisë Dimal, në mbledhjen e tij të datës 09/07/2021, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur dhe relatuar nga Drejtoria e Asistencës së Fermerit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar në Bashkinë Dimal, në zbatim të Ligjit Nr 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, Neni 55, Ligjit Nr 57/2020 "Për Pyjet" Neni 25, pika 1.a, Vendim Nr 591 datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në vendimin Nr 1353 datë 10.10.2008" të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor", të ndryshuar; ç) Miratimin me shkrim për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor me vendim të Këshillit Bashkiak, brënda territorit administrative të të cilit është sipërfaqja pyjore, e cila do tu nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor, Ligj Nr 34/2021 datë 16.03.2021 "Për Ndryshimin e Emërimit të Njësisës së Qeverisjes Vendore nga "Bashkia Ura Vajgurore" në "Bashkia "Dimal", Fletore Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Numri 55 e Enjte, 8 Prill 2021

VENDOSI

Me 8 vota PRO 4 vota KUNDËR dhe 2 vota ABSTENIM nga 14 Këshilltarë prezentë të miratojë :

1. Të shprehë dakordësinë për vazhdimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor publik, për zhvillimin e aktivitetit të agroturizimit, për sipërfaqen prej 17,84 ha, Ekonomia Pyjore Bregu i Poshnjes dhe Mali i Kozares nga Shoqëria Salillari shpk.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Dimal dhe Drejtoria e Asistencës së Fermerit, Shërbimit Pyjor, Mbrojtjes Konsumatore dhe Shërbimit Veterinar në Bashkinë Dimal.
3. Sipërfaqja përkatëse e fondit pyjor që do të ndryshojë destinacion mbetet në pronësi të Bashkisë Dimal.
4. Sipërfaqja e cila paraqet numrin më të madh të pemëve në këtë ngastër mos të preket nga investimi dhe të vijojë të jetë e pyllëzuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas 10 ditësh nga shpallja dhe miratimi në Prefekturë .

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha



